

VENDIM
Nr.532, datë 22.11.1999

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.493, DATË
13.8.1998, "PËR CAKTIMIN E RREGULLAVE PËR SHITJEN E PASURIVE TË
PERSONAVE JURIDIKË, JOBANKARË, QË KANË MARRË HUA NGA PUBLIKU I
GJERË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6.4, të ligjit nr.8386, datë 30.7.1998 "Për mënyrën dhe procedurat e shitjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", me propozimin e Kryeministrit Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.493, datë 13.8.1998, bëhen këto shtesa:

Pas pikës 11 shtohet pika 11/1 me këtë përmbajtje:

"Administratorët, në shitjen publike me tender të pasurive të shoqërive huamarrëse në administrim marrin vendim për caktimin e kohës së publikimit, për radhën e shitjes së asetëve dhe të çmimit orientues të shitjes. Cikli i publikimit për shitjen e pasurive të shoqërive huamarrëse në administrim kryhet jo më pak se dy herë, me kohë publikimi 20 ditë për secilin cikël.

Kur, pas përfundimit të publikimit të dytë, aseti nuk është shitur, administratorët e përbashkët marrin vendim për shitjen drejtpërdrejtë pranë Qendrës së Ankandit, në prani të komisionit të vlerësimit të ofertës konkurruese, duke respektuar çmimin e tregut të përcaktuar nga shoqata e vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme."

2.Pas pikës 12 shtohet pika 12/1, me këtë përmbajtje:

"Pasuritë e personave të shpallur debitorë dhe të personave që duhet të kthejnë vlerat financiare, të përfituara nga transaksionet e pronësisë, pas sekuestrimeve prej zyrave të përmbartimit gjyqësor, kalojnë në pronësi të administratorëve, për shitje, pranë Qendrës së Ankandeve.

Kriteret, rregullat dhe procedurat e shitjes publike me tender janë të njëjta me ato që zbatohen në shitjen e pasurive të shoqërive huamarrëse dhe të personave të tjerë, të deklaruar të lidhur me ta."

3.Ngarkohen administratorët e pavarur dhe Grupi Mbikëqyrës, për ndjekjen dhe zbatimin e këtijvendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta